



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 1764 / prot. 20

Tiranë, më 25.03.2022

URDHËR

Nr. 131, datë 25.03.2022

“PËR

MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISJET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, nenit 15, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër, Korçë dhe Fier.
2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër, Korçë dhe Fier.
3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në qarkun Durrës, Dibër, Korçë dhe Fier me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Urdhri nr.124, datë 23.03.2022 “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla” shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

